Flash Të shtënat me armë në Durrës, ndërron jetë Armando Baboçi 39 vjeç

HAPJA E LISTAVE ATENTAT PRENG GJINI KORONAVIRUS

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

U plagos pas një sherri në Durrës, ndërron jetë një nga të plagosurit

2

Të shtëna me armë në Durrës pas një sherri/ Vdes babai, plagoset i biri! Kapet autori, shoqërohen 5 të tjerë (VIDEO)

3

Bollino: Miliona e miliona lekë nga 'oligarkët' ndaj dy familjeve në PD dhe mediave të saj

4

Ekskluzive/ Mjeti e tërheq zvarrë dhe i merr jetën 57-vjeçarit në Elbasan (PAMJE TË RËNDA)

5

E moshuara lëshon 'bombën' në 'Pa Gjurmë', zbulon përdhunuesin e vajzës dhe flet për djalin që erdhi në jetë: Hasmi im ishte babai i nipit

Aktualitet

Elbasan/ Ekzekutohet në 60 sec vëllai i Talo Çelës, 20 gëzhoja në vendin e ngjarjes! 3 autorët u veshën si policë, RENEA kontrolle në Bradashesh, 6 të shoqëruar (VIDEO)

Tre persona të veshur si policë kanë ekzekutuar me armë zjarri Bujar Çelën, (vëllai i Talo Çelës) teksa po konsumonte kafenë e mëngjesit në një lokal në fshatin Bradashesh. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 05:45, ku 62-vjeçari ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Forca të shumta të RENEA-s janë përqendruar në Bradashesh ku po zhvillojnë kontrolle të shumta dhe kanë ngritur postobllоqe. Deri tani janë shoqëruar 6 persona që mendohet se mund të kenë dijeni apo të dhëna për ekzekutimin e Bujar Çela.

- LSI: Lleshaj Taulanti dhe Sandri çojnë "Shqiponja" të ruajnë zbatimin e masave anti COVID-19, këtej krimi vlon
- Pronari i lokalit: Çela nuk ishte problematik
- Çela punonte si taksist në të zezë, priste udhëtarët nga Greqia
- Kush është Talo Çela, njeriu më i kërkuar i momentit

Report TV -Elbasan/ Ekzekutohet në 60 s nda vëllai i Talo Çelës, 20 gëzhoja në vendin ...

Redaksia
17 Shtator, 07:15 | Përditesimi i fundit: 17 Shtator, 20:07

Tweet

ELBASAN- Në një hark kohor brenda 60 sekondash është ekzekutuar mëngjesin e sotëm, teksa pinte kafenë, Bujar Çela, vëllai i Talo Çelës (në kërkim për grabitjen e Rinasit *më 9 prill 2019*). Tre persona të maskuar si policë kanë zbrazur rreth 20 plumba, të pa shqetësuar nga askush, ku një nga autorët ka qenë i armatosur me një pushkë dhe 2 të tjerët me pistoleta, duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme Çelës.

Report Tv mëson se kamerat e sigurisë kanë kapur tre autorët, të cilët zbritën nga mjeti 'Renault' dhe qëlluan në drejtim të Çelës, ndërkohë që pak minuta më pas kjo makinë me targa AA 876 DC u gjet i

Jogobella
JANE
PA KONSERVANT
TE FRESKETA
ME COPEZA FRUTASH

MINUTË PAS MINUTE

21:21

U plagos pas një sherri në Durrës, ndërron jetë një nga të plagosurit

21:20

Humb kontrollin e 'Benz'-it e përfundon në dyqanin ushqimor, 23-vjeçari shoqërohet në komisariat

21:04

Kontrollet e policisë në Berat, arrestohen 5 persona e vihen në hetim 1 tjetër

20:57

FMN: 12 trilionë $ humbje në botë nga COVID-i, Shqipëria rënie mbi 5%

20:50

Frenohet largimi nga puna i punonjësve! Në gusht u punësuan 1460 persona më shumë

djegur, pak km nga vendi i ngjarjes, më konkretisht në fshatin Murras.

LEXO EDHE:
Vrasja e Runajt dhe Ramazanit në Elbasan, zbulohet dhe kapet porositësi! Kush është 34-vjeçari që në 2018 iu ekzekutua vëllai në sy të familjes (EMRI)

Ekzekutimi mafioz ka ndodhur rreth orës 05:45, atëherë kur Çela konsumonte çdo mëngjes kafenë, për shkak se punonte taksist ku priste udhëtarë që vinin me autobusë nga Greqia. Makina e tij tip "Benz" me targa AA 020 UZ, që e përdorte si taksi ishte parkuar në hyrje të lokalit në Bradashesh, ku Çela po konsumonte kafenë. Pronari i hotelit ku u ekzekutua Çela tha se kishte dëgjuar zhurmë, e ndërsa e cilësoi atë si një njeri shumë të mirë, aspak problematik.

Report Tv ka shkuar në vendin e ngjarjes ku ajo çfarë ka mbetur nga ai ekzekutim është çakmaku dhe cigaret e Çelës, teksa në muret e lokalit janë të dukshme shenjat e plumbave. Në vendngjarje janë sekuestruar 20 gëzhoja. Forca të shumta të RENEA-s janë përqendruar në Bradashesh ku po zhvillojnë kontrolle të shumta dhe kanë ngritur postoblloqe. Deri tani janë shoqëruar 6 persona nga dy familje që mendohet se mund të kenë dijeni apo të dhëna për ekzekutimin e Bujar Çela.

Pista kryesore e hetimeve është për shkak të përfshirjen kriminale të vëllait të tij, Talo Çela në grabitjen e Rinasit si dhe dyshimet për disa vrasje në Durrës, mes tyre dhe ***vëllezërve Haxhia*** në Durrës.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:50

Kontrolle për vrasjen e Bujar Çelës, forcat RENEA mbërrijnë në Elbasan (VIDEO)

Report TV -Kontrolle për vrasjen e Bujar Çelës, forcat RENEA m...

Policia e Elbasanit dhe Renea kanë ngritur postoblloqe në rrethrotullim e Brandasheshit, dyshohet se ky kontroll po bëhet në lidhje me vrasjen e Bujar Çelës.

Kontrolle për vrasjen e Bujar Çelës, forcat RENEA mbërrijnë në ...

Me te lexuarat e dites | Me te lexuarat e javes

Lajme | Fotogaleri | Videogaleri

1. 'Me filxhan kafeje në dorë, më pas i shtrirë përtokë', momenti i ekzekutimit të Bujar Çelës (FOTO)
2. I mbijetoi atentatit me tritol, Preng Gjini flet nga spitali: Nuk jam në hasmëri dhe nuk ruhesha! S'mbaj përgjegjësi për veprimet e vëllai
3. 'Ligji për presidentin', Meta kërcënon me shpërndarjen e parlamentit: Po deshën le ta provojnë, të mos dinë ku të futen! S'më frikëson asnjë i marrosur
4. A do të jetë Sali Berisha kandidat për deputet? Basha nuk mendohet dy herë: Po, do garojë ku të dojë ai (VIDEO)
5. Jep dorëheqjen sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, Plarent Ndreca
6. 'Berisha të kandidojë ku të dojë', Braçe ironizon: Saliu do ishte i denjë për deputet në Gërdec ose Bulevard
7. Jep dorëheqjen zv.drejtori i Policisë së Tiranës
8. Ekskluzive/Fushata e sulmeve të Berishës ndaj Azem Hajdarit në dhjetor '96, akuzat dhe diversionet përmes RD-së, kërcënimet deri në përjashtim nga PD
9. Këshilli politik, palët dalin më të përçara se kurrë! Bylykbashi: Presim përgjigjen e Gjiknurit për ODIHR! Hajdari: Propozimi i PS nuk hap listat!
10. 'Ligji për presidentin' Meta kërcënon me shpërndarjen e parlamentit: Po deshën le ta provojnë, të mos dinë ku të futen! S'më frikson asnjë i marrosur

Ora 13:19

Plumbat në muret e lokalit, çakmaku dhe cigarja në tavolinë...çfarë ka mbetur në vendin e ngjarjes ku u ekzekutua vëllai i Talo Çelës

Plumbat në mure, çakmaku e cigarja në tavolinë...pamje nga lo...

Report Tv është zhvendosur në Bradashesh , në vendin ku është ekzekutuar Bujar Çela. Siç shihet në pamjet që Report Tv shenjat e plumbave janë të dukshme në ambientet e lokalit, ku po konsumonte kafenë e mëngjesit Çela. Në tavolinë ka mbetur çakmaku dhe cigarja që konsumonte Çela.

Kamerat e sigurisë në lokal, shenjat e plumbave dhe çakmaku në tavolinë

Ora 09:58

Vëllai i Talo Celës u ekzekutua në 60 sekonda, 20 gëzhoja në vendin e ngjarjes! Kamerat filmuan 3 autorët

Vëllai i Talo Celës u ekzekutua në 60 sekonda, 20 gëzhoja në v...

Report Tv mëson se kamerat e sigurisë kanë kapur tre autorët të cilët kanë ekzekutuar vëllanë e Talo Çelës, të cilët zbritën nga mjeti 'Renault; që u gjet i djegur disa km larg vendngjarjes. Mësohet se një nga autorët ka qenë i armatosur me një pushkë dhe 2 të tjetër me pistoleta të cilët kanë qëlluar me breshëri armësh në harkun kohor prej 60 sekondash, të pa shqetësuar nga askush duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Pista kryesore e hetimeve është për shkak të përfshirjen kriminale të vëllait të tij, Talo Çela në grabitjen e Rinasit si dhe dyshimet për disa vrasje në Durrës. Në vendngjarje janë sekuestruar 20 gëzhoja.

Ora 08:37

Duke larë me zorrë uji gjakun në vendngjarje/ Flet pronari i lokalit: Bujar Çela ishte njeri shumë i mirë, jo problematik (VIDEO)

Duke larë me zorrë uji gjakun te lokali/ Flet pronari: Bujar Çela s...

Report Tv ka siguruar dëshminë e pronarit të lokalit, ku u ezkekutua Bujar Çela. *"Pinte kafe në mëngjes. S'ka pasur probleme fare. Ka qenë shumë- shumë i mirë. Isha brenda kur ndodhi ngjarja",* thotë ai, teksa shihet shumë i qetë duke larë me zorrë uji gjakun e mbetur nga vrasja.

Ora 08:35

FOTO/ Ky është vëllai i Talo Çelës që u ekzekutua teksa pinte kafenë, punonte taksist në të zezë

1 / 12
REPORT TV

Viktima Bujar Çela

Report Tv ka siguruar foton e Bujar Çelës, i cili u ekzekutua mëngjesin e sotëm teksa pinte kafenë e mëngjesit.

Ora 08:22

Kush është Bujar Çela/ Punonte si taksist në të zezë, priste udhëtarët që vinin me autobusët e Greqisë

Viktima Bujar Çela

Report Tv mëson se Bujar Çela, vëllai i Talo Çelës, punonte si taksist pa licencë. Ai priste udhëtarët që vinin me autobusët e Greqisë.

Makina që Bujar Çela përdorte për të punuar si taksist

Ora 08:01

Atentati në Elbasan/ Vëllai i Talo Çelës u ekzekutua nga tre persona, autorët të veshur me uniformë policie

Atentati në Elbasan/ Gazetari Qyno: Vëllai i Talo Çelës u ekzeku...

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga ekzekutimi i vëllait të Talo Çelës, Bujar çela. Gazetari i Report Tv, Ronaldo Gjoshi raporton se kanë qenë tre persona, të veshur me uniformë policie që kanë hyrë në lokal dhe kanë ekzekutuar me armë zjarri Bujar Çelën, teksa po pinte kafenë e mëngjesit. Mjeti që po shihni në foto është makina në pronësi të Bujar Çelës. Policia ka ngritur pika kontrolli në hyrje-dalje të qytetit të Elbasanit. Mësohet se zona është e monitoruar me kamera, për shkak se aty pranë janë tre karburante, të cilat mund të ndihmojnë në zbardhjen e të gjithë dinamikës së ngjarjes.

Ora 07:37

Kush është Talo Çela, njeriu më i kërkuar i momentit që sot iu ekzekutua vëllai kur po pinte kafenë e mëngjesit

Kush është Talo Çela, njeriu më i kërkuar i momentit që sot iu e...

Talo Çela është person i shpallur në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar, pasi Gjykata për Krimet e Renda Tiranë i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Vrasja e punonjësit të policisë” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, “Vjedhja me armë e kryer në bashkëpunim”, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe “Vrasja me paramendim, kryer në bashkëpunim”.

Çela është autori i dyshuar i ngjarjes së datës 9 prill 2019, ndodhur në pistën e aeroportit “Nënë Tereza”, në Rinas, Tiranë, ku persona të maskuar, nën kërcënimin e armëve të zjarrit, kanë arritur të vjedhin një sasi të konsiderueshme vlerash monetare të cilat po ngarkoheshin në avion dhe më pas gjatë shkëmbimit të zjarrit me Policinë, mbeti i vrarë njëri prej autorëve kryesorë të kësaj ngjarjeje.



Talo Çela, vëllai i viktimës

Gjithashtu ky ai dyshohet se fshihet pas atentatit me armë zjarri të **2 vëllezërit Haxhia në Durrës.** Emri i Talo Çelës ka dalë në dritë përmes dëshmisë së të penduarit të drejtësisë, Klevis Alla, të arrestuar për vrasjen e vëllezërve Haxhia. E bashkë me të, Report Tv mëson ekskluzivisht, se në kërkim është shpallur edhe Nuredin Dumani. Bashkëpunëtori i drejtësisë ka deklaruar se ditën e vrasjes kanë qenë edhe vetë Talo Çela dhe Nuredin Dumani, dhe e gjitha sipas tij lidhet me disa lekë të humbura.

Deri tani në pranga për vrasjen e dy vëllezërve janë 22-vjeçari Klevis Alla, që bashkëpunoi me policinë duke treguar se ku kishin hedhur armët e krimit të përdorura në atentatin ndaj vëllezërve Haxhia dhe Altin Ndoci. Ndërsa në këkrim janë Talo Çela dhe Nuredin Dumani.

Vëllezërit Haxhia të vrarë në Durrës

Ora 07:35

'Skenë krimi'/ Ky është lokali ku u ekzekutua vëllai i Talo Çelës teksa pinte kafenë e mëngjesi! Pamje nga vendngjarja

Elbasan/ Ekzekutohet teksa pinte kafenë vëllai i Talo Çelës (në ...

Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes ku u ekzekutua vëllai i Talo Çelës, Bujar Çela. Mësohet se ai është ekzekutuar teksa po pinte kafenë e mëngjesit në një lokal në Bradashesh.

Ora 07:30

Ekzekutimi i vëllait të Talo Çelës/ Gjendet e djegur një makinë në Elbasan (VIDEO)

Ekzekutimi i vëllait të Talo Çelës/ Gjendet e djegur një makinë n...

Gjendet një makinë e djegur në fshatin Murras, dyshohet se u përket autorëve. Report Tv sjell foto nga automjeti i djegur, tip 'Renault' me targa AA 876 DC.



Makina e djegur sot që dyshohet se përdorën autorët për vrasjen

er.k./I.K./Shqiptarja.com

TAG: elbasan BUjar Çela talo cela atentat vellait te talo celes

Ⓒ Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A po zbatohen masat anti-Covid në shkolla?

Po Jo Nuk e di

Komento

Komente

Brvao: 17/09/2020 19:51

Bravo cuanve te reneas ngrini postoblloqe se do vin vrasesit te marin makinen e djegur ta shesin per hekur bravo dhe lleshit ajo bmw jote zotri lleshi versiioni baz dmth me e lodhura fillon nga 97 mij euro gjer ne 170 e me tutje shikoje njeher ca i keni ber ketij vendi po ☝Zoti eshte i madh mbase ndonje nga keta plumba qorra u kap ndonje njeri qe keni me shum ne zemer te shikoni si eshte dhimbja pastaj

Përgjigju

Shoku: 17/09/2020 14:33

Ky Talo Cela i papame ne mengjes pi kafe me te ne darke te fut plumbin dhe thote e kisha mik.Me eurot qe ka ne perdorim do mbaj nje ushtri te tere dhe shume shpejt do godasi.

Përgjigju

> **Shoku shoku:** 17/09/2020 17:16
>
> E cfare vlere ka tani qe i vrane vellain per faj te tij??? Ky bam, ata te tjeret bam. I rrofshin leket dhe jeta e qenit qe ben.

Ema: 17/09/2020 10:49

Po e lyve doren me mjalt te vin grenzat mbrapa e ska qeveri te te bej derman po te pakten mos ket te pafajshem ne vend ngjarje sa per opoziten di lehin se ska rrug gjeter

Përgjigju

Tan Hoxha: 17/09/2020 10:06

Ngjarje e paralajmeruar.

Përgjigju

Law enforcement: 17/09/2020 09:20

Ore mos u beni budallenj edhe tendencioz mos e politizoni, ai qe ka esape per te lare do ti laj heret ose vone. Nuk ka Llesh edhe Rame ne bote qe ti ndaloj. Tjetri ka vrare do te vrit harroeni ate muabet.Dashte zoti mos vriten te pa fajshem

Përgjigju

Alb: 17/09/2020 09:18

Keta te prisnin te pakten se taulanti me lleshajn sa dhan dhe gjith ate deklarat kemi sjell laraskat ne elbasan tha lleshaj do bejm namin.

Përgjigju

Law: 17/09/2020 09:17

I hengren leket e Rinasait 7 a 8 ne burg 5 a 6 te vrare, tafmaja e madhe te le pa gje.

Përgjigju

Trendeline dhe Kenge: 17/09/2020 08:41

Jasha Albanistani, ose me sakte Afganistani. Ku eshte ai derdimeni ministri syleshi. Edi Rama, qerohu bashke me turmen pa tru, qe po "drejton" kete vend.

Përgjigju

Beni: 17/09/2020 09:05

O shqupi, te jap te drejt per ministrin, ja e qeruham dhe Edin, po pastaj ke do vem? Lulin?Monen? Ik e shok mo na hap barkun

Lomi: 17/09/2020 08:29

Po ca tu desh intervista mor Talo, e more ne qaf vllane, keshtu eshte kur bo pastrusin, heret a vone fillojne te pastrojne.

Përgjigju

Dencja: 17/09/2020 08:27

Ketyre dhe u kerkohet lekura, dhe nuk rrin dot pa e "konsumuar" kafen e mengjezit ne lokal. Popull rrote ky i yni.

Përgjigju

Www: 17/09/2020 09:48

KY e ka honger nga vllaij o bylmet, shpejt ti kane lidh telat kete radhe o Tale.

toni: 17/09/2020 08:17

un akoma nuk kuptoj se si ky lleshi a preshi ca ka emrin nuk jep doreheqjen! ka qene ministri me i dobet i brendshem i te gjitha kohrave. policia me te lulezoi ne mos zbulimin dhe mos parandalimin e krimit

Përgjigju

A. N.: 17/09/2020 10:15

Nuk ka faj lleshi por qeveria qe lejon drogen te trafikohet haptas nga te gjitha anet.

A...Zh: 17/09/2020 08:00

Zbulimi i ngjarjeve te renda, autoreve e motiveve, eshte ne vetvete parandalim. Per aq kohe sa kjo nuk behet si duhet, zinxhiri i vrasjeve e krimeve veshtire te keputet. Eshte reklamuar krijimi i disa strukturave antikrim ne polici, por efektiviteti i tyre nuk po duket akoma.

Përgjigju

Justice: 17/09/2020 22:47

Welcome to Albania

Noku: 17/09/2020 10:36

Te vritesh per zararet e vellait nderkohe qe punon taksist qne fshat qe te nxjerresh buken, e tmerrshme.

Lajme të tjera

Aktualitet

Humb kontrollin e 'Benz'-it e përfundon në dyqanin ushqimor, 23-vjeçari shoqërohet në komisariat

18 Shtator, 21:16

Aktualitet

Kontrollet e policisë në Berat, arrestohen 5 persona e vihen në hetim 1 tjetër

18 Shtator, 21:02

Aktualitet

Bollino: Miliona e miliona lekë nga 'oligarkët' ndaj dy familjeve në PD dhe mediave të saj

18 Shtator, 20:37

Aktualitet



Policia e Elbasanit dhe RENEA sërish pika kontrolli në Brandashesh (VIDEO)

18 Shtator, 20:30

Aktualitet



Të shtëna me armë në Durrës pas një sherri/ Vdes babai, plagoset i biri! Kapet autori, shoqërohen 5 të tjerë (VIDEO)

18 Shtator, 20:27

Aktualitet

'Shqiponjat' dhe FNSH-ja në ditën e dytë të kontrolleve, zbarkojnë në Fier, Elbasan, Fushë-Krujë dhe Berat (VIDEO)

18 Shtator, 20:21

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje